



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

PROJEKT – VENDIM

Nr. datë . 2025

PËR
“MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË
STREHIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS KRYESISHT NË ZONA
INFORMALE KU BANOJNË MË SHUMË SE 50 FAMILJE”, FINANCUAR ME
FONDET E BUXHETIT TË SHETIT

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pikat 1, nënpikat 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, kreu II nenit 4, pika ç, kreu III neni 11, pika b, të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, vendimit nr 216, datë 13.04.2023, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, sipas Termave të Referencës për Projektet e Investimit që do të Financohen nga Buxheti i Shtetit në vitet 2025-2026, Drejtoria e Shërbimit Social, zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ____/____/2025.

PROPOZOI:

1. Miratohet nisja dhe realizimi i projekteve për përmirësimin e infrastrukturës në kuadër të programit të strehimit social, sipas shpjegimeve të relacionit bashkëngjitur.
2. Ky projekt synon rritjen e cilësisë së jetesës për përfituesit e programeve të strehimit, për përmirësimin e infrastrukturës dhe qasje në shërbimet publike, me fokus familje në nevojë, familje me anëtarë persona me aftësi të kufizuar, të moshuar, sipas listës bashkëngjitur.
3. Fondi në masën 30% të vlerës së preventivit, me shumën 5'460'678'.83 lekë do përballohet nga fondet e bashkisë Kolonjë me buxhetin e vitit 2025.
4. Ky projekt-vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak.
5. Për zbatimin e tij ngarkohet administrata e Bashkisë.

Konc: Spec A. Dajlani

Miratoi: Drejtori D.SH.S.ZH.E.F.E. Dake

Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P.O. Lifo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE

RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIM
Nr. Datë ____/____/2025

PËR
“MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË STREHIMIT
PËR PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS KRYESISHT NË ZONA INFORMALE KU
BANOJNË MË SHUMË SE 50 FAMILJE”, FINACUAR ME FONDET E BUXHETIT TË
SHTETIT

Të nderuar,

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, kreu II nenit 4, pika ç, kreu III neni 11, pika b, të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, vendimit nr 216, datë 13.04.2023, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, sipas Termave të Referencës për Projektet e Investimit që do të Financohen nga Buxheti i Shtetit në vitet 2025-2026, Drejtoria e Shërbimit Social, zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, sipas relacionit shpjegues paraqet për miratim projekt-vendimin për përmirësimin e infrastrukturës, në rrugën “Xhafer Ameliu”, të qytetit të Ersekës në jug-lindje të hyrjes nga Korça ,gjatësia e rrugës 650m, pas plotësimit të dokumentacionit nga ana e Drejtorisë së Zhvillimit dhe Planifikimit të Territorit, sipas listës së familjeve përfituese bashkëngjitur relacionit.

Për këtë zonë të dorëzohet projekt për përmirësimin e infrastrukturës nga Programet e Strehimit Social, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, duke parë se aty jetojnë një pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, invalidë pune, etj., përfitues nga programet sociale.

Nga ana Drejtorisë së Shërbimit Social, referojmë si zonë me përparësi për ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës, rrugën "Xhafer Ameliu", zonë e cila u krijua si zonë banimi pas vitit 1990, ku në ambientet e strehimit të kafshëve dhe ambienteve të punëtorëve, gjatë këtyre viteve u vendosën disa familje, dhe aty përshtatën këto ambiente, në shtëpi banimi. U krijua si zone e re e shtuar qytetit të Ersekës, me mungesa të dukshme të infrastrukturës. Disa shtëpi ende janë të mbuluara me internit, një material ky i dëmshëm dhe për jetesën.

Duke parë zhvillimin e kësaj zone, e referojmë që të nisin përmirësimi i infrastrukturës, duke u shtrirë më pas në zona të tjera të qytetit, ku dhe ndërhyrjet kanë qenë më të pranishme.

Ju Faleminderit!

Konc: Spec A. Dajlani

Miratoi: Drejtori D.SH.S.ZH.E.F.E. Dajlani

Konfirmoi: Drejtori D.Ç.J.P.P O. Ljilja



Lista e familjeve përfituese nga projekti i përmirësimit të infrastrukturës nga programet e strehimit social

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. Anëtarë	Kategoria
1	Qemal Lumani	2	Pensionist
2	Ramiz Avdyli	4	
3	Dylber Isufi	3	
4	Arben Kamberi	3	
5	Meço Zylfo	3	Ndihmë ekonomike, person me AK
6	Alfred Avdyli	1	Ndihmë ekonomike
7	Maksim Banushi	3	
8	Thodhor Ilia	2	Pensionist
9	Gani Dule	3	
10	Fatmir Koxha	2	Pensionist, ndihmë ekonomike.
11	Azis Osmani	2	
12	Filip Dake	4	
13	Anxhela Dake	3	
14	Astrit Dake	2	
15	Teki Beqo	3	
16	Ibrahim Cenko	3	
17	Artur Cenko	2	Ndihmë ekonomike
18	Kostandin Loli	2	Invalid Pune
19	Sotirag Dhori	2	Pensionist

Konceptoi:

Specialisti: Artiola Dajlani

Drejtore e Shërbimit Social
Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve
Elfaneada DAKE

KRYETARI I BASHKISË
Erion ISA

